



BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTAR

Informacion

MBI HAPAT E NDËRMARRË NGA BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTARË PËR SUBJEKTET QË PREKEN NGA NDRYSHIMI I LIGJIT NR. 9975, DATË 28.07.2009, "PËR TAKSAT KOMBËTARË", SI DHE PROPOZIME PËR NDRYSHIME LIGJORE

Gjatë javës së dytë të muajit janar, disa nga anëtarët e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë u ankuan se ishin prekur nga ndryshimet e fundit të paketës fiskale 2019, në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar, dhe me konkretisht neni 4, pika 8.1 për taksën e lëndëve të para në formë primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së dhe që përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës.

Problemi i taksimit të lëndëve të para filloi të adresohet dhe nga shumë prodhues të tjerë vendas duke lënë të kuptohet shtrirjen e një kategorie të gjerë prodhuesish të prekur nga kjo taksë, si:

- prodhues të materialeve/artikujve plastikë;
- prodhues hekuri;
- prodhues boje;
- prodhues sfungjeri;
- prodhues të mobilerisë;
- termoizolimit;
- plastmasi që përdoret për bujqësi;
- prodhues i tubave të plastikës për ndërtim infrastrukturë (ujësjellës dhe kanalizime);
- prodhim i arkave të plastikës;
- prodhim sandale/çizme plastike;
- veshjes së brendshme me pelicola të thasave të çimentos, miellit;
- etj..

Nisur nga problematikat dhe shqetësimet e shprehura nga shumë prodhues vendor mbi këtë taksë, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë vijoi me një sërë takimesh dhe analizash teknike me qëllim argumentimin e saktë të dëmit që kjo masë i shkakton industrive prodhuese në vend.

Pasi bëmë një analizë paraprake të efekteve ekonomiko-financiare dhe sociale që ka shkaktuar ky ndryshim i ligjit tek prodhuesit vendas, **më datë 25 janar 2019**, zhvilluam një tryezë teknike ku morën pjesë 30 subjekte nga fusha të ndryshme të prodhimit. Gjatë mbledhjes subjektet treguan mbi dëmet ekonomike që u janë shkaktuar nga ndryshimi i ligjit, ulja e prodhimit vendas, ulja e eksporteve, shkurtimet e vendeve të punës deri në mbyllje të aktivitetit. Njëzëri prodhuesit u shprehën se me ndryshimet e këtij ligji goditen prodhuesit vendas dhe favorizohet importi.

Më datë 26 janar 2019, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë zhvilloi një takim me Ministren e Financës dhe Ekonomisë znj. Anila Denaj, me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes z. Eduard Shalsi, si dhe ekspertët fiskal. Pas diskutimeve të zhvilluar në këtë tryezë dhe vënie më dijeni të situatës së shkaktuar nga ndryshimi taksës, u informuam se Ministria e Financave është duke përgatitur një draft-udhëzim në zbatim të ligjit ku tenton të bëjë disa rregullime në lidhje me pikën 8.1 të tij, me qëllim lehtësimin e problemit.

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë angazhoi një nga ekspertët më të mirë të Taksave dhe Doganave i cili pasi u njoh me parashikimet e udhëzimit paraqiti një raport vlerësimi me argumentimet përkatëse.

Më datë 30 janar 2019, u zhvillua një tryezë teknike me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes z. Eduard Shalsi dhe përfaqësues të kabinetit të tij, me Zëvendës Ministrin e Financave dhe Ekonomisë z. Elton Haxhi si dhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave znj. Belinda Ikonimi.



BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTAR

Pas analizimit të përcaktimeve që Ministria e Financave dhe Ekonomisë kishte parashikuar në udhëzim, u verejt se:

1. Përcaktimet e këtij draft-udhëzimi konsiderohen se e tejkalon përcaktimet ligjore dhe nuk mund të aplikohet;
2. Tenton të zgjidhë problemin për disa kategori artikujsh/materialesh por lë jashtë zgjidhjes një pjesë të madhe të sektorit të prodhimit si polisterolin, tubat plastikë, prodhuesit e plastmasit bujqësor, arkat e plastikës, etj.;
3. Për kategoritë që tenton të lehtësojë nga barra e taksës, shton shumë burokracinë procedurale për tu pajisur me autorizim për import dhe në procedurat midis palëve;
4. Nuk është parashikura sakte çështja e rimbursimit në eksport;
5. Rrit mundësinë e abuzimit dhe korrupsionit nga organet tatimore dhe doganore duke lënë hapsire për keqinterpretim dhe keqzbatim të ligjit dhe udhëzimit;

Nisur për sa më sipër Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dërgoi një shkresë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrisë Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes “Mbi raport vlerësimin e projekt udhëzimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008, “Për taksat Kombëtarë”, nga ku propozoi që pika 8.1 e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të hiqet duke e kthyer situatën në gjendjen e mëparshme ku taksa për lëndën e parë në formë primare, të importuara në krrerët 3901 deri në 3914, të NKM-së të jetë zero.

Më datë 27 shkurt 2019, u zhvillua një takim më përfaqësues të Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë dhe Ministres së Financave znj. Anila Denaj. Gjatë takimit na u informua se kishte dalë Udhëzimi nr.9, datë 20.2.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”. Ministria Denaj kërkoi që Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë pas analizimit të këtij udhëzimi, të shkojë me një propozim për zgjidhjen e situatës.

Pas studimit dhe analizimit të këtij udhëzimi u konkludua se parashikimet e ligjit dhe më pas sqarimet në udhëzim ndajnë në tre kategori industritë që trajtohen dhe impaktohen:

1. Industritë që nuk lehtësohen nga ky udhëzim (taksohen rishtas);
2. Industritë që mendohet se lehtësohen por paraqesin problem në interpretim;
3. Industritë që lehtësohen nga parashikimet e udhëzimit por që përballen me një shtesë të barrës procedurale, kosto administrative të lartë, etj.

Udhëzimi nuk ofron siguri juridike, është kontradiktor, rrit burokracionë, krijon terren për abuzim dhe si rrjedhojë nuk përbën zgjidhje reale. Për këtë arsye, Komiteti i Legjislacionit, Taksave dhe Procedurave zhvilloi dy takime, përkatësisht në datat **1 dhe 4 mars 2019**, në të cilën u vendosën që Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë të dali me këto propozime:

1. Niveli i taksës për lëndët e para plastike në forma primare në kategorinë 3901-3914, importuar nga subjekte të cilët përdorin lëndë të parë për import, për prodhimin e artikujve/materialeve që nuk kategorizohen në grupin e plastikës, por që produkti final kategorizohet në materiale ndërtimi/mobileri/industrinë ushqimore/bujqësi, të bëhet në 0 lek/kg. Përjashtimi nga kjo taksë të kryhet me autorizim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, duke kërkuar nga subjekti informacion për përkrahimin e lëndës së parë, kodin doganor përkatës, listën e produkteve finale që kompania ka tregtuar dhe deklaratimet e shitjeve gjatë një viti. Informacioni i lartëpërmendur duhet të dorëzohet çdo fillim viti pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore. Në këtë përjashtim të përfshihen dhe importuesit e lëndëve të para të cilët furnizojnë industrinë, pasi aktualisht nuk trajtohen as nga ligji dhe as nga udhëzimi i fundit.
2. Niveli i taksës për lëndët e para plastike në formë primare 3901-3914, duke shtuar edhe kodin 3923, për prodhimin e ambalazheve dhe pipetat për shishet plastike, të bëhet 5 lekë për kg.
3. Niveli i taksës për artikuj/materialet plastikë të importuara në kapitullin 39, të ngelet 35 lek/kg, me përjashtim të lëndëve të para në formë primare të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi;
4. Duke qenëse ndërhyrjet e fundit në legjislacion kanë për qëllim reduktim e ndotjes, kërkohet që 30% e shumës së taksës së mbledhur t'i kthehet në formë rimbursimi shoqërive të riciklimit të plastikës të cilët janë të vetmet që mund të sigurojnë aktivizimin e ekonomisë qarkulluese në Shqipëri përsa i



BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTAR

përket plastikës. Ky rimbursim të bëhet në përfundim të ciklit të prodhimit pasi të paraqiten të dhënat reale të faturimit.

Takimet me përfaqësues të Ministrive dhe Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë do të vijojnë deri në fund të muajit prill 2019, të cilët shpresojmë të arrihet më propozime konkrete në dobi të sipërmarrësve vendas.